



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Data: 01.10.2024

Drejtuar: "S I L V E R" me NIPT K88010301S

Adresa: Njësia Bashkiake nr 5, Rruga Bajram Curri, Pallatet 1 Maji, Godina nr 7, Shkalla 4, Kati 1-rë, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar", Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për secilin lot do të shpallet një operator ekonomik fitues.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Loti 1: REF-15232-08-02-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti 1: "Shërbim gatimi dhe shpërndarje Ushqimi për Spitalin Rajonal Shkodër", me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj, me fond limit: 79,307,647 (shtatë dhjetë e nëntë milion e tre qind e shtatë mijë e gjashtë qind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH, ose 791,967.71 (shtatëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e një) Euro pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: **Nr. 47 datë 12.08.2024**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "DION-AL"

Emri i plotë i shoqërisë

K67917301H

numri i NIPT-it

Vlera: 73 465 240 (shateëdhjetë e tre milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dyzetë) lekë pa TVSH

2. “SORI-AL”

Emri i plotë i shoqërisë

K31510059D

numri i NIPT-it

Vlera: 65 468 268.66 (shateëdhjetë e tre milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dyzetë) lekë pa TVSH

2. “NIKA”

Emri i plotë i shoqërisë

J76705047U

numri i NIPT-it

Vlera: 65 387 440 (gjashtëdhjetë e pesë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzetë) lekë pa TVSH

2. “S I L V E R”

Emri i plotë i shoqërisë

K88010301S

numri i NIPT-it

Vlera: 76 513 680 (shtatëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “DION-AL”

K67917301H

Përkatësisht për arsyet si më poshtë:

Operatori ekonomik “DION-AL”sh.p.k, me NUIS K67917301H nuk plotëson pikën 2.1.2, të seksionit 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e 1(një) stabilimenti të licensuar për prodhimin e ushqimit brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Mbi këtë kërkesë, ofertuesi duhet të vërtetonte detyrimisht disponimin e një stabilimenti brenda bashkisë Shkodër ku ndodhet vendi ku zbatohet marrëveshja kuadër, Spitali Rajonal Shkodër. Subjekti “DION-AL”sh.p.k referuar liçensës të paraqitur me numër LN-8823-10-2019, rezulton se disponon stabiliment në adresën Bushat Q/F: Adresa: Barbullush, Objekt, Kati I, Zona Kadastrale 1100, Pasuria Nr. 363/10/ND; territor i cili ndodhet në njësinë administrative Bushat Bashkia Vau i Dejes, dhe për këtë arsye ofertuesi nuk e plotëson kërkesën për kualifikim.

2. “SORI-AL”

K31510059D

Përkatësisht për arsyet si më poshtë:

Operatori ekonomik “SORI-AL”sh.p.k, me NUIS K31510059D, nuk plotëson pikën 2.1.2, të seksionit 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e 1 (një) stabilimenti të licensuar për prodhimin e ushqimit brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër.

Mbi këtë kërkesë ofertuesi duhet të vërtetonte detyrimisht disponimin e një stabilimenti brenda Bashkisë Shkodër ku ndodhet vendi ku zbatohet marrveshja kuader, Spitali Rajonal Shkodër. Subjekti “SORI-AL” sh.p.k, referuar liçensave të paraqitura me numër LN-9898-07-2015; LN-2369-11-2016 dhe LN-0308-09-2009, rezulton se disponon stabiliment në respektivisht Bashkia Berat, Bashkia Vlorë, Bashkia Tirane, dhe për këtë arsye ofertuesi nuk e plotëson kërkesën për kualifikim.

3. “NIKA”

J76705047U

Përkatësisht për arsyet si më poshtë:

Operatori ekonomik “NIKA” shpk me NUIS J76705047U nuk plotëson pikën 2.1.1, të seksionit 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e Licencës të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, e cila duhet të lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

Licenca e paraqitur nga OE “NIKA” shpk LN-3194-04-2011 dhe Vendimi i QKL me numer DN-4294-02-2021-02, ka veprimtari dhe kufizime specifike “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Restorant)”, pra liçensa e paraqitur në këtë procedurë nga subjekti ofertues nuk është në përputhje me fushën specifike të veprimtarisë objekt prokurimi e cila është “Shërbim gatimi dhe shpërndarje Ushqimi për Spitalin Rajonal Shkodër”. Licenca e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor duhet të përfshijë si veprimtari specifike shërbimin e gatimit dhe shpërndarjen e tij, pra si veprimtari specifike e licencës II.1.A.1 duhet përveç gatimit edhe shpërndarja, pra shoqëritë pjesëmarrëse duhet të kenë si veprimtari specifike shërbim katering.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “S I L V E R” me NIPT K88010301S, me adresë: *Njësia Bashkiake nr 5, Rruga Bajram Curri, Pallatet 1 Maji, Godina nr 7, Shkalla 4, Kati 1-rë, Tiranë*, se oferta e paraqitur me vlerë të përgjithshme prej 76 513 680 (shtatëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit. Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR